



BULETIN MUJOR

NËNTOR 2024



PËRMBAJTJA

- AKSK Takim me Institucioneve që do të përfshihen në planin e strategjisë së re të sigurisë kibernetike.
- Forcimi i bashkëpunimit për sigurinë kibernetike
- Trajnimi Dy-Ditor "Phishing & Ransomware Response: TTX"
- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve/ Tafa: "Është koha që bullizmi kibernetik & format e tjera të ngacmimit online të trajtohen si vepra penale."
- AKSK Priti Vizitën e Zyrtarëve të SHBA-së për Forcimin e Sigurisë Kibernetike në Shqipëri
- Përforcimi i Sigurisë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor: Dialog Rajonal për Politikat dhe Bashkëpunimin në Mbrojtjen Digjitale

AKSK takim me institucioneve që do të përfshihen në planin e Strategjisë së Re të Sigurisë Kibernetike.



Në kuadër të hartimit të strategjisë së re të sigurisë kibernetike 2025-2030, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ftoi të gjithë aktorët që do të përfshihen në planin e veprimit për forcimin e kësaj strategjie. Qëllimi kryesor është përmirësimi i ekosistemit kibernetik, duke sjellë një qasje të re për mbrojtjen e infrastrukturave kritike, sigurimin e qytetarëve dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në rajon dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.



Forcimi i bashkëpunimit për sigurinë kibernetike

U zhvillua në Tiranë konferenca dy-ditore për sigurinë kibernetike, organizuar nga UNDP Shqipëri, UNDP në Stamboll dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Ky takim mbledhi agjenci të sigurisë kibernetike nga Ballkani Perëndimor, Gjeorgjia dhe Moldavia për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe për të ndihmuar në zhvillimin e strategjive të forta. Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e një qasjeje të unifikuar ndaj kërcënimeve kibernetike, ndërsa përfaqësuesi i UNDP Albania, z. Francisco Roquette, nënvizoi domosdoshmërinë e ndarjes së informacionit dhe reagimit të koordinuar.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039



Zhvillohet Trajnimi “Phishing & Ransomware Response: TTX”

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit, CRDF Global, CYSEG dhe MAGMA zhvilluan një trajnim të fokusuar në përgatitjen e profesionistëve të sigurisë kibernetike nga sektori publik dhe privat për të përballuar sfidat e phishing dhe ransomware, duke përmirësuar aftësitë e tyre për reagimin ndaj incidenteve.

Drejtori i Autoritetit, Igli Tafa, në ceremoninë hapëse, theksoi rëndësinë e forcimit të kapaciteteve në sigurinë kibernetike dhe vizionin për krijimin e një Akademie Kombëtare të Sigurisë Kibernetike për trajnimin e ekspertëve nga Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor.

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve/ Tafa: “Është koha që bullizmi kibernetik & format e tjera të ngacmimit online të trajtohen si vepra penale.”

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, AKSK organizoi një aktivitet për të diskutuar mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe nevojën për përmirësimin e kuadrit ligjor. Drejtori i AKSK, Igli Tafa, theksoi nevojën për të trajtuar bullizmin kibernetik dhe ngacmimin online si vepra penale dhe apeloj për raportimin e rasteve. Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e partnerëve dhe nxënësve të Tiranës, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërgjegjësimin për sigurinë në internet.



AKSK Priti Vizitën e Zyrtarëve të SHBA-së për Forcimin e Sigurisë Kibernetike në Shqipëri

AKSK mirëpriti znj. Liesyl Franz, Asistente Sekretare për Hapësinë Ndërkombëtare Kibernetike në SHBA, e cila u takua me Drejtorin e Përgjithshëm, z. Tafa. Ata diskutuan mbështetjen e SHBA-së për forcimin e sigurisë kibernetike në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve teknike të ekspertëve shqiptarë dhe mbështetjeve nga Departamenti Amerikan i Shtetit për përmirësimin e infrastrukturave kritike të informacionit. Ky bashkëpunim synon ndërtimin e një ekosistemi kibernetik të sigurt për zhvillimin dhe stabilitetin digjital të Shqipërisë.



Përforsimi i Sigurisë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor. Dialog Rajonal për Politikën dhe Bashkëpunimin në Mbrojtjen Digjitale

Më 20-21 nëntor 2024, AKSK dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës, organizuan një dialog rajonal në Tiranë, duke mbledhur 60 pjesëmarrës nga Ballkani Perëndimor, Europa dhe SHBA. Agjenda trajtoi bashkëpunimin rajonal në mbrojtjen kibernetike, diplomacinë kibernetike, mbrojtjen e infrastrukturave kritike dhe luftën kundër krimit kibernetik. Drejtori i AKSK, Igli Tafa, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për sigurinë kibernetike, ndërsa Maartje Peters theksoi përfshirjen e gjithë shoqërisë në luftën kundër kërcënimeve kibernetike.

